



Prishtinë, 01 korrik 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2228_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike të OSSH;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2556_06_24** i dt.10.06.2024;

në seancën e mbajtur më datë 01 korrik 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET Pjesërisht** ankesa e konsumatorit **Viva Frutta Sh.p.k., - A.SH**, nga Komuna e Gjilanit, përfaqësuar nga **Sejdiu dhe Qerkini – Av. Burim Azemi**, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II. KESCO** duhet të anulohet korrigjimin plotësues nr. 26572DGL-9023370 datë 10.10.2017 në vlerë 33,379.56€.
- III. KESCO** duhet të bëjë korrigjimin e faturave nga periudha 11/2016 deri në periudhën 07/2017 duke marrë për bazë faktorin e korrigjimit $K=1.62$
- IV.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Konsumatori **Viva Frutta Sh.p.k., - A.SH** në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 20.11.2017 përmes përfaqësuesit të autorizuar Zyra e Avokatisë "Sejdiu dhe Qerkini – Av. Burim Azemi" ka apeluar Vendimin e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 24.10.2017 lidhur me kontestimin e plotësues nr. 26572DGL-9023370 datë 10.10.2017, për shkak të dyshimit të matjes dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 51284853.

Me datë 10.06.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranimin e grupeve matëse kanë larguar nga matja GM me nr. 96257063 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=11061.266$ kWh dhe $TU=6793.725$ kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv $TL=7272.886$ kVAr dhe $TU=4937.588$ kVAr me konstantë llogaritëse $C=100$ dhe kanë vendosur për matje GM nr. 51284853 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=000000$ kWh dhe $TU=000000$ kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv $TL=000000$ kVAr dhe $TU=000000$ kVAr me konstantë llogaritëse $C=100$. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar edhe matjet e pjesës sekondare: $U1=229$, $U2=229$ dhe $U3=229$, $I1=5.2/0.05$, $I2=5.3/0.05$ dhe $I3=4.1/0.04$.



Provë: procesverbali-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 020908 datë 10.06.2016

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 22.08.2017 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr.51284853, ku përveç evidentimit e të dhënave teknike të pikës matëse kanë evidentuar se: *“Sipas të dhënave nga AMR, vërehet dallim i madh mes rrymave I L1 dhe I L2 me rrymën I L3. Verifikohet se lidhja elektrike është e lidhur gabimisht. S1 e TMRR1 është lidhur ne “2”, të njehsorit, faza e dytë, (S1) e TMRR 2 është i lidhur në “1” të njehsorit, faza e 1. S1 i TMRR 2 është i lidhur me S1 dhe TMRR 3 – Raporti i Rrymave sipas tabelës së mësipërme. Të bëhet korrigjimi sipas AMR. Rregullohen lidhjet elektrike. Pllombohet njehsori dhe TMRR”.*

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 047346 i datës 22.08.2017

Departamenti i Faturimit në KESCO me datë 10.10.2017 përmes urdhër lejimit nr. 26572DGL-9023370 kanë ngarkuar konsumatorin korrigjimin plotësues prej **33,379.56€** duke bërë korrigjimin e faturave per periudhën një vjeçare 08/2016 deri ne periudhën 07/2017 bazuar në Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 047346 i datës 22.08.2017, me faktor korrigjues $K=2.14.....$

Provë: Korrigjimi nr. 26572DGL-9023370 datë 10.10.2017

Me datë 13.10.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KESCO duke kërkuar që t’i behet ri shqyrtimi i korrigjimit financiar nr. 26572DGL-9023370 datë 10.10.2017, për shkak të dyshimit ne matje, leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 51284853.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 13.10.2017.

Me datë 24.10.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në Procesverbalin e dt. 22.08.2017, fotografitë nga vendi i ngjarjes, dhe vendimin e komisionit për korrigjime të faturave të dt. 19.10.2017, si dhe në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 24.10.2017.

Me datë 20.11.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar që të aprovohet në tërësi ankesa e parashtruar nga ankuesi, që të anulohet Vendimi i lëshuar nga KESCO i dt. 24.10.2017 si dhe që të anulohen pasojat e faturave të lësuara ndaj V.F Sh.p.k.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datë 20.11.2017

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KESCO-s, ka vërejtur se:

Me datë 10.06.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it per pranimin e grupeve matëse kanë larguar nga matja GM me nr. 96257063 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=11061.266$ kWh dhe $TU=6793.725$ kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv $TL=7272.886$ kVAr dhe $TU=4937.588$ kVAr me konstantë llogaritëse $C=100$ dhe kane vendosur per matje GM nr. 51284853 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=000000$ kWh dhe $TU=000000$ kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv $TL=000000$ kVAr dhe $TU=000000$ kVAr me konstantë llogaritëse $C=100$. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar edhe matjet e pjesës sekondare: $U1=229$, $U2=229$ dhe $U3=229$, $I1=5.2/0.05$, $I2=5.3/0.05$ dhe $I3=4.1/0.04$



Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 22.08.2017 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr.51284853, ku përveç evidentimit e të dhënave teknike të pikës matëse kanë evidentuar se: *“Sipas të dhënave nga AMR, vërehet dallim i madh mes rrymave I L1 dhe I L2 me rrymën I L3. Verifikohet se lidhja elektrike është e lidhur gabimisht. S1 dhe TMRR1 është lidhur ne “2”, të njehsorit, faza e dytë, (S1) e TMRR 2 është i lidhur në “1” të njehsorit, faza e 1. S1 i TMRR 2 është i lidhur me S1 dhe TMRR 3 – Raporti i Rrymave sipas tabelës së mësipërme. Të bëhet korrigjimi sipas AMR. Rregullohen lidhjet elektrike. Pllombohet njehsori dhe TMRR”.*

Bordi i ZRRE ka analizuar po ashtu rrjedhën e përgjithshme të energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike përkatësisht pas intervenimit të ekipeve të KEDS-it me datë 22.08.2017 e tutje, konsumatori ka rritje të shpenzimit të energjisë elektrike. Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik nr. 96257063 dhe nr. 51284853 para dhe pas ndërhyrjeve të ekipeve të KEDS-it konstatohet se konsumatori për periudha të njëjta kohore ka dallime në shpenzimin e energjisë elektrike. Për periudhën 09/2017-05/2018 pas rregullimit të kyçjeve nga ekipet e KEDS-it në GM nr. 51284853 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **51,314 kWh(aktiv)** kurse për periudhën e njëjtë para ndërhyrjes 09/2015 - 05/2016 me njehsorin nr. 96257063 është **31,695 kWh(aktiv)** e që përkthyer në përqindje kemi ngritje të shpenzimit prej **62%** pas ndërhyrjes në kyçjet e njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE po ashtu ka bërë edhe krahasimet për periudha të njëjta kohore të me vonshme me dy njehsorët elektrik nr. 51284853 dhe nr. 84721824 dhe konstaton se ka ndryshim në shpenzim krahasuar me njehsorin elektrik nr.96257063 dhe shpenzimet para ndërhyrjes në kyçjet e njehsorit elektrik nr.51284853. Me njehsorin elektrik nr. 51284853 për periudhën 09/2018 deri në periudhën 05/2019 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **54,246 kWh(aktiv)**, për periudhën 09/2019 deri në periudhën 05/2020 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **56,155 kWh(aktiv)**, për periudhën 09/2020 deri në periudhën 05/2021 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **70,081 kWh(aktiv)**, për periudhën 09/2021 deri në periudhën 05/2022 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **62,183 kWh(aktiv)** kurse me njehsorin e ri nr.84721824 për periudhën 10/2022 deri në periudhën 05/2023 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **60,219 kWh(aktiv)** si dhe periudhën 09/2023 deri në periudhën 05/2024 është **66,067 kWh(aktiv)**. Bordi i ZRRE-së bazuar në shqyrtimet e profileve të ngarkesave të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 51284853 nga periudha 07/2016 konstaton se ka dallime në I1 dhe I2 krahasuar me I3 pra këto profile të rrymave në dy fazat e para kanë qenë shumë më të ulëta, apo që edhe shumica e tyre është pothuajse e njëjtë me I3 dhe se kjo gjendje është përmirësuar vetëm me datë 22.08.2017 kur tri profilet e rrymave janë pothuajse të njëjta.

Bazuar në kodin e matjes përkatësisht nën 3.9.4 dhe 3.9.5 (Testimi i njehsorëve me pajisje portabel) si dhe nën 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave të caktuara kohore si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Në nën 3.9.4 thuhet se: *“Së paku 1 (një) herë në dy vite ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër”,* kurse në nën 3.9.5 thuhet se: *“ Testimi nga OSSH në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht për Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose varësisht nga rasti që paraqitet”,* e që në rastin e konsumatorit ZRRE ka kërkuar raportet e testimin dhe që të njëjtat i ka pranuar nga KEDS. Bazuar në analizimin e procesverbaleve të shqyrtimit nr. 040429 date 20.09.2016 dhe procesverbalit me nr. 040481 date 26.10.2016 të bëra para ndërhyrjes në njehsorin elektrik nr. 51284853, vërtetohet se ekipet e autorizuar të KEDS kanë bërë shqyrtimin e njehsorit nr. 51284853 dhe se në dy rastet kanë evidentuar se njehsori është në rregull, përkatësisht kanë evidentuar se: *Rrymat dhe Tensioni në një Kuadrant, RST dhe diagrami në rregull, e bllobuar”* . Sipas të dhënave teknike të evidentuara në procesverbale ZRRE vërteton se edhe në këto dy



procesverbale shihet se profilet e rrymave ne I1 dhe I2 janë konsiderueshëm me te ulëta se I3 por qe ekipet e KEDS-it nuk kane evidentuar çfarëdo mos përputhje apo edhe gabime te kycjeve ne njehsor. Kurse me nenin 4.3.1 dhe 4.3.2 përcaktohet se:” Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e mirëfilltë të kablllove, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plombave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga KEDS konstatohet se nenet 3.9.4 dhe 3.9.5 janë respektuar nga KEDS per periudhën e kërkuar pasi që janë ofruar procesverbalet me te cilët vërtetohet shqyrtimi periodik I grup matësit te konsumatorit. Po ashtu me Ligjin per Energjinë Elektrike, neni 54 paragrafi 1 thuhet se: **Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë** e që duke pasur parasysh edhe faktin që njehsori si dhe kycjet janë bërë nga ekipi I KEDS-it ne periudhën 06/2016 vërteton se konsumatori nuk ka pasur qasje ne ndërhyrjen e matjes së njehsorit elektrik apo ne kycjet e njehsorit.

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korrigjimin nr. 26572DGL-9023370 datë 10.10.2017 i cili është bere nga Departamenti i faturimit ne KEDS si dhe mënyrën e kalkulimit te këtij korrigjimi, duke marre per baze vetëm se per periudhën kontestuese I3 është e sakte per shkak se I1 dhe I2 kane regjistrim me te ulet se I3, dhe konstaton se jo gjithmonë ngarkesat mund te jenë te njëjta dhe se edhe ky korrigjim duke marre per baze vetëm vlerat e lartpërmendura nuk mund te paraqet 100% shpenzim real te konsumatorit. Andaj, Bordi duke marre per baze edhe shpenzimet e konsumatorit pas ndërhyrjes/rregullimit te sistemet matëse te konsumatorit konstaton se ky korrigjim duhet te behet duke marre per baze mesataren e shpenzimeve te konsumatorit pas ndërhyrjes.

KEDS po ashtu ka ofruar Procesverbali-Protokoli mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 017567 datë 17.09.2022 me te cilin vërtetohet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it per pranimin e grupeve matëse kanë larguar nga matja GM me nr. 51284853 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=24566.558 kWh dhe TU=15497.657 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=05579.273 kVAr dhe TU=03500.111 kVAr me konstantë llogaritëse C=100 dhe kane vendosur per matje GM nr. 84721824 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=000000 kVAr dhe TU=0000000 kVAr me konstantë llogaritëse C=100. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar edhe matjet ku: U1=236, U2=236 dhe U3-236, I1=33/0.33, I2=47/0.47 dhe I3=46/0.46 me çka edhe vërtetohet se gjithçka është ne rregull me ngarkesat e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, Raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 020908 datë 10.06.2016, procesverbalet e shqyrtimit nr. 040429 date 20.09.2016 dhe nr. 040481 date 26.10.2016, Raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 047346 i datës 22.08.2017, respektimin e neneve 3.9.4 dhe 3.9.5 te Kodit te matjes që kanë te bëjnë me inspektimin dhe testimin e pajisjeve matëse multifunksionale (GP) brenda periudhës se caktuar, nenin 4.3.2 të Kodit të matjes me te cilin është e përcaktuar përgjegjësia e mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik si dhe nenin 54 paragrafin 1 të Ligjit per Energjinë Elektrike, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO,
- Konsumatorit: **A.SH- Viva Frutta Sh.p.k.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.